



Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës,
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797
Mail: info@aab-edu.net;
www.aab-edu.net

Ref. nr. 322 /2024 Prishtinë, 07/06 /2024

Në bazë të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutit të Kolegit AAB, Senati me datën 10/05/2023 miraton këtë:

Kod të Etikës

Qëllimi Neni 1

- Qëllimi i Kodit Etik është të përcaktoj sjelljen etike të personelit akademik, jo akademik dhe të studentëve në Kolegjin AAB.
- Ky Kod i Etikës është hartuar duke u bazuar në parimet e përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë, me qëllim të sigurimit të:

- lirisë akademike,
- mundësive të barabarta,
- standardeve të larta profesionale dhe etike,
- transparencës dhe përgjegjësisë sociale,
- sjelljeve të virtytshme,
- parandalimit të sjelljes jo etike,
- përmirësimit të imazhit të institucionit.

Neni 2

Ky Kod i Etikës aplikohet për stafin akademik, jo akademik, studentët dhe të gjitha palët e ndërlidhura me institucionin.

Neni 3 Vlerat thelbësore

- Vlerat thelbësore të cilat duhet të mirëmbahen dhe të promovohen nga të gjithë anëtarët e komunitetit të institucionit janë:

- 1.1. Liria Akademike
- 1.2. Ndershmëria Akademike
- 1.3. Qasja e barabartë
- 1.4. Llogaridhënia dhe Përgjegjësia Sociale
- 1.5. Mbrojtja e pronës intelektuale

Neni 4 Parimet

1. Të gjithë anëtarët e komunitetit të institucionit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Larte të cilat janë pjesë e institucionit, pritet të sillen në përputhje me parimet e përgjithshme të etikës siç janë:

- 1.1. integriteti
- 1.2. ndershmëria
- 1.3. e vërteta
- 1.4. transparencë
- 1.5. respektimi i të tjerëve
- 1.6. besimi
- 1.7. llogaridhënia
- 1.8. paanshmëria
- 1.9. barazia
- 1.10. drejtësia
- 1.11. altruizmi
- 1.12. objektiviteti
- 1.13. liria akademike.

2. Këto parime vlejnë në raport me:

- 2.1. organin qeverisës, drejtuesit dhe organe të tjera të institucionit;
- 2.2. personelin akademik dhe administrativ;
- 2.3. studentët, dhe
- 2.4. çdo person tjeter apo grup që ka marrëdhëniet kontraktuale ose të një lloji tjeter apo interes për punën e institucionit.

Neni 5 Rregullat kryesore për stafin akademik dhe administrativ

1. Në mbështetje të këtyre parimeve të përgjithshme, të gjithë pjesëtarët e stafit akademik dhe administrativ të institucionit:

- 1.1. duhet të vendosin interesat e institucionit mbi interesat e tyre dhe nuk duhet të kërkojnë të përsitojnë nga pozitat e tyre në mënyra të ndryshme nga ato që parashikojnë rregulloret e institucionit dhe legjislacioni në fuqi;
- 1.2. nuk duhet të pranojnë asnjë udhëzim për veprim ose mosveprim në një mënyrë të caktuar nga asnjë individ, me përjashtim të një autoriteti mbikëqyrës, nga asnjë parti politike, sindikate ose grup fetar, me përjashtim të atyre që parashikon legjislacioni në fuqi;
- 1.3. në lidhje me persona ose grupe brenda apo jashtë institucionit, nuk duhet të kërkojnë dhe as të pranojnë ryshfete apo shpërblime të tjera të paligjshme financiare, ose të kërkojnë apo pranojnë ndonjë nderë tjeter personal, që mund t'i ndikojë në punën e tyre dhe duhet menjëherë të njoftojnë autoritetin përkatës për çdo përpjekje për të kërkuar ryshfet apo ndere të tjera personale ashtu siç përcaktohet në Rregulloren e institucionit;

- 1.4. duhet t'i paraqesin një deklaratë me shkrim Rektorit, nëse ata ose një familjar i afërt, kanë interesa personale në çështje që ndikojnë punën e tyre, burimet njerëzore (përfshirë emërimet dhe rritje në detyre të personelit), çështjet financiare, kontraktuale apo probleme të tjera lidhur me to;
- 1.5. nuk duhet të keqpërdorin burimet e institucionit apo informacionin konfidencial, personal ose tregtar që zotërohet nga ai, përfshi pronësinë intelektuale, për përfitime vetjake apo të një personi ose grupei tjeter;
- 1.6. kur marrin pjesë në emërimin, ngritjen në detyre apo komisione të tjera që ndikojnë në personelin akademik apo administrativ, duhet të sillen me profesionalizëm dhe në përputhje me parimet etike të renditura më sipër;
- 1.7. kur marrin pjesë në komisione ose organe të tjera që merren me pranimin, vlerësimin, provimin dhe veprime të tjera që lidhen me studentët, si dhe në aktivitete individuale dhe në grup me studentët, duhet të sillen me profesionalizëm dhe në përputhje me parimet etike të renditura më sipër;
- 1.8. kur marrin pjesë në veprimtari kërkimore, nuk duhet të përfshihen në plagjiaturë, të përdorin punën e të tjerve si të veten apo të falsifikojnë rezultatet,
- 1.9. të respektojnë parimet etike për mbrojtjen e të dhënave personale brenda fushëveprimit të punës së tyre;
- 1.10. të përbahen nga veprimet me të cilat mund t'i sjellin dëm institucionit duke mos zbatuar obligimet kontraktuale gjatë kohëzgjatjes së kontratës;
- 1.11. ndalohet çfarëdo formë e kushtëzimit, shfrytëzimit, ngacmimit apo trajtimit diskriminues të studentëve apo duke vendosur kushte për kalimin e provimit, blerjen e literaturës së caktuar, ose duke kërkuar favore politike, financiare, seksuale ose favore tjera;
- 1.12. ndalohet çdo sjellje në raport me kolegët dhe stafin tjeter të institucionit me qëllim të ndonjë përfitimi personal apo ndonjë personi të tretë;
- 1.13. në rast të mbajtjes të ndonjë pozite menaxheriale brenda institucionit, atëherë duhet të përbahet nga deklarimet publike me përbajtje fyeze, politike, fetare etj.
- 1.14. ndalohet çdo formë e diskriminimit në baza politike, racore, fetare, gjinore, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike, origjinës kombëtare, prejardhjes, statusit martesor, paaftësisë fizike apo mendore;
- 1.15. obligohen të respektojnë afatet kohore të përcaktuara lidhur me orarin e ligjératave, ushtrimeve, provimeve, konsultimeve, kohën e mbledhjeve të përcaktuara nga institucioni, dhe vetëm ne raste të veçanta apo pas miratimit nga institucioni lejohen përjashtime;
- 1.16. obligohen të kenë paraqitje dhe veshje të përshtatshme, e cila i përshtatet natyrës së punës dhe studimeve;
- 1.17. duhet të përbahen nga deklarime me përbajtje fyeze ndaj të gjithë pjesëtarëve të komunitetit të institucionit por edhe ndaj personave të tretë që nuk janë pjesë e institucionit;
- 1.18. duhet të kujdesen që sa më mirë të përfaqësojnë institucionin duke kontribuar në ngritjen e imazhit dhe jo të kundërtën;
- 1.19. duhet të përbahen nga veprimet të cilat mund të cenojnë imazhin e institucionit, përfshirë publikimin apo postimin e përbajtjeve të papërshtatshme në rrjetet sociale dhe platforma të tjera relevante;

- 1.20. personeli akademik dhe jo akademik i rregullt duhet të paraqesë përkatësinë (punëdhënësin) e tij në të gjitha rrjetet sociale dhe profesionale në platformat elektronike;
- 1.21. duhet të paraqesin-denoncojnë sjelljet joetike të kolegëve të tyre ose shkeljen e dispozitave të këtij kodi apo rregullave tjera të institucionit;
- 1.22. ndalohet shtyrja apo nxitja e të tjerëve për mos respektimin e rregullave të institucionit apo në veprime tjera të ndaluara;
- 1.23. ndalohet përdorimi i paautorizuar i burimeve të institucionit për qëllime të përfitimit personal, për qëllime politike, fetare etj.;
- 1.24. ndalohet përdorimi i autoritetit, pozitës apo emrit të institucionit për përfitime personale me palë të treta ose jashtë institucionit;
- 1.25. ndalohen të gjitha format e lobimit, shantazhit, kërcënimit, ryshfetit, korruptionit dhe veprime tjera që bien ndesh me profesionin e mësimdhënësit.

Neni 6 Rregullat kryesore për studentët

1. Përveç rregullave të parapara në nenin paraprak të cilat aplikohen për student, të gjithë studentët gjatë periudhës së studimeve, duhet gjithashtu të përbahen nga sjellja jo e mirë akademike dhe pandershëmëria akademike si në vijim:

- 1.1. plagjiatura apo marrja e punimeve të tjera pa i theksuar referencat mirë;
- 1.2. dorëzimi i punimit të njëjtë më shumë se një herë;
- 1.3. marrëveshjet/bashkëpunimet e fshehta mes studentëve;

Neni 7 Përkufizimi i plagiaturës

1. Plagiatura, në përputhje me standartet ndërkombëtare, definohet si praktika e marrjes së punës dhe / ose ideve të dikujt tjetër duke pretenduar se janë origjinale.
2. Në përputhje me definicionin e përgjithshëm, plagiatura përkufizohet më tutje si në vijim:

- 2.1. Marrja fjalë-për-fjalë të tekstit apo fjalive nga një burim pa e cituar atë burim;
- 2.2. Ndryshimi i fjalëve dhe frazave kyçe, por duke ruajtur përbajtjen thelbësore të burimit;
- 2.3. Parafrazim nga burime të shumta dhe të kombinuar për t'u përshtatur së bashku;
- 2.4. Huazimi bujar nga vepra e mëparshme e shkrimtarit pa citim;
- 2.5. Kombinimi i burimeve të cituara me pasazhe të kopjuara pa citim;
- 2.6. Përfshirja e citimeve të burimeve joekzistente ose informacione të pasakta në lidhje me përbajtjen e burimeve;
- 2.7. Përfshirja e citimeve të duhura në burime, por punimi kopjon përbajtjen e punës origjinale;

Neni 8
Mekanizmat kundër plagjiaturës

1. Mekanizmat kundër plagjiaturës kanë të bëjnë me rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin.
2. Në nivelin e ndërgjegjësimit, studentët dhe staf akademik, pajisen me paketa informuese të cilat pëershkruanë parimet e integritetit dhe sjelljes akademike, dhe të cilat janë specifike dhe të përshtatura për secilin akter veç e veç.
3. Në nivelin e parandalimit, varësisht nga lloji i punimeve dhe/apo vlerësimeve, përdoren procedura dhe softuerë kundër plagjiaturës.
 - 3.1. Procedurat përfshijnë komunikimin e obliguar dhe minimal në mes të studentit dhe stafit akademik për detyrën dhe/apo punimin e studentit, dhënien e informatave kthyese për punimet dhe/apo vlerësimet e studentit, nënshkrimin e deklaratës nën betim se punimi i studentit është origjinal, etj.
 - 3.2. Softuerët kundër plagjiaturës përdoren nga stafi akademik për detyra, ese dhe tekste të tjera të shkruara përgjatë lëndëve të ofruara.
4. Në nivelin e disertacionit bachelor dhe master, përpos elementeve të përmendura në nën paragrafin 3.1 të këtij neni, softueri kundër plagjiaturës përdoret detyrimisht me dorëzimin e disertacionit.
5. Për të kaluar tema e diplomës tek komisioni vlerësues, mentorët obligohen të dorëzojnë një raport kundër plagjiaturës që detajon nivelin e plagjiaturës së kryer në tezë.
6. Niveli i pranueshëm i plagjiaturës është rezultati prej 20%, që përputhet me frazat e cituara në gjithë temën.
7. Nëse zbulohet më shumë se 20% plagjiaturë, tema e diplomës nuk mund të dorëzohet për shqyrtim te komisioni vlerësues. Në vend të kësaj, studentit i kërkohet të rishikojë dhe rishkruajë pjesë të disertacionit.

Neni 9
Komision i Etikës

1. Komision i Etikës është komision i themeluar nga Senati i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë nga radhët e stafit të brendshëm.
2. Së paku njëri nga anëtarët e Komisionit të Etikës duhet të jetë nga fusha e drejtësisë.
3. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Etikës është 4 vite.

Neni 10

1. Një anëtarë mund të bëhet i papërshtatshëm për të qenë pjesë e Komisionit të Etikës nëse:

- 1.1. mungon më shumë se 3 herë në mbledhje të komisionit;
- 1.2. nuk është më pjesë e stafit të brendshëm;
- 1.3. nuk kryen obligimet që ka ndaj komisionit;
- 1.4. shkaqe tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në punën e Komisionit të Etikës.

2. Nëse paraqitet ndonjëri prej rasteve të parapara në pikën 1, atëherë Rektori mund të propozojë plotësimin me anëtarë të ri të Komisionit të Etikës për pjesën e mbetur të mandatit.

Neni 11

1. Komisioni i Etikës është përgjegjës pér trajtimin dhe vendosjen në shkallë të parë pér të gjitha shkeljet etike.

2. Komisioni i Etikës, vendimet i merr në bazë të provave të siguruara, deklaratave dhe duke organizuar seancë dëgjimore pér personin e denoncuar.

3. Të drejtëni e paraqitjes-denoncimit të shkeljeve e ka çdo anëtar i komunitetit të brendshëm të institucionit, apo edhe nga jashtë të cilët nuk janë të përfshirë në ndonjë formë në institucion.

4. Shkelja mund t'i adresohet drejtpërdrejt Komisionit të Etikës, ose përmes Rektorit apo Dekanit të Fakultetit.

Neni 12

1. Ndaj vendimeve të Komisionit të Etikës, në afat prej 15 ditësh, është e lejuar ankesa në Këshillin Drejtues.

2. Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të Etikës e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 13

Masat pér shkeljet etike

1. Komisioni i Etikës ndaj një personeli akademik, varësisht nga natyra e shkeljes, mund të shqiptojë këto masa:

- 1.1. vërejtje me shkrim;
- 1.2. ulja e pozitës;
- 1.3. ndëshkim finansiar;
- 1.4. ndalim pér mentorim të kandidatëve;
- 1.5. ndalim pér përfshirje në komisione vlerësuese dhe komisione të temave;
- 1.6. marrjen e thirrjes shkencore apo akademike;
- 1.7. ndërprerja e marrëdhënies së punës.

2. Komisioni i Etikës ndaj një personeli administrativ, varësisht nga natyra e shkeljes, mund të shqiptojë këto masa:

- 2.1. vërejtje me shkrim;
- 2.2. ulja e pozitës;
- 2.3. ndëshkim finansiar;
- 2.4. suspendim pa pagesë nga vendi i punës për maksimum tre (3) muaj;
- 2.5. ndërprerja e marrëdhënies së punës.

3. Komisioni i Etikës ndaj një studenti, varësisht nga natyra e shkeljes, mund të shqiptojë këto masa:

- 3.1. vërejtje me shkrim;
- 3.2. para-përjashtim;
- 3.3. ndalim i nënshtrimit të provimeve për një afat apo më shumë;
- 3.4. suspendim nga Fakulteti për një (1) vit;
- 3.5. përjashtim përgjithmonë nga Fakulteti.
- 3.6. revokimin e titullit dhe anulimin e diplomës.

4. Komisioni i Etikës mund të shqiptojë edhe masa tjera që i vlerëson të arsyeshme dhe që ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e sjelljes.

5. Të gjitha shkeljet të cilat përbajnjë elemente të veprës penale, trajtohen nga organet kompetente sipas ligjeve të aplikueshme.

Neni 14

1. Të gjitha shkeljet të natyrës etike të stafit akademik, trajnohen sipas këtij Kodi nga Komisioni i Etikës.

2. Për të gjitha shkeljet e natyrës etike të parapara me këtë Kod nga studentët dhe stafi jo akademik, vendos Komisioni i Etikës.

3. Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore, që përfshijnë stafin administrativ dhe studentët, rregullohen me Rregulloren për Masat dhe Procedurën Disiplinore.

Neni 15

Komisioni i Etikës mund të nxjerrë Rregulloren e Punës dhe të përcaktojë mënyrën e marrjes së vendimeve.

Neni 16

Me miratimin e këtij Kodi të Etikës, shfuqizohet Kodi i Etikës Nr. 1314/2021 i datës 17/12/2021 dhe Vendimi nr. 279/2023 i datës 10/05/2023.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky Kod i Etikës hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori.



Prishtinë, Qershori 2024



Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës,
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797
Mail: info@aab-edu.net;
www.aab-edu.net

Ref. nr. 322 /2024 Prishtinë, 07/06/2024

Senati i Kolegit AAB, më datën 07/06/2024 mori këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET Kodi i Etikës.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Prorektorëve
2. Dekanëve

Dr. sc. Blerim Olluri, Rektor

